



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 634/3 prot.

Tiranë, më 05.05.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 634/1, DATË 24.04.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT, PA NDONJË VENDIM PËRFUNDIMTAR NDAJ VEPRIMTARISË SË GJYQËSORE TË GJYQTARËVE Z. S.D., Z. V.H., DHE ZNJ. GJ.G., LIDHUR ME ANKESËN E PARAQITUR NGA SHTETASI SKËNDER RRAPAJ"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e z. Skënder Rrapaj me nr. 2814 prot., datë 23.11.2020, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magistratëve z. S.D., z. V.H., dhe znj. GJ.G., gjyqtarë në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe me vendimin nr. 634/1, datë 24.04.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për përfundimin e procedurës së verifikimit, pa ndonjë vendim përfundimtar ndaj veprimtarisë së gjyqësore të gjyqtarëve z. S.D., z. V.H., dhe znj. GJ.G., lidhur me ankesën e paraqitur nga shtetasi Skënder Rrapaj", bazuar në nenin 95 të ligjit 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, nenet 117, 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Vlorë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjja: "10 Korriku", Rruga: "Adem Jashari";
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

